



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Nr. Prot.	01-4273/13
Br. Prot.	
Prot. No.	
Data	16.12.2013
Datum	
PRISHTINE	

DATE/A:	16/12/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Xhemajl BUZUKU Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
CC:	z. Xhavit DAKAJ Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin “ Ndërtimi i objektit të Shkollës Speciale në Mitrovicë “

I nderuari z. Buzuku

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin “ Ndërtimi i objektit të Shkollës Speciale në Mitrovicë “ me nr. të prokurimit: 208 13 067 511 Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “ Ndërtimi i objektit të Shkollës Speciale në Mitrovicë “ në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka përgatitë “ Njoftimin për Kontratë ” me titull “ Ndërtimi i objektit të Shkollës Speciale në Mitrovicë ” me nr. Prokurimi 208 13 067 511, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 03.10.2013, në Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit të kësaj procedure të prokurimit në “ Njoftimin për Kontratë ”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me Procedurat e Prokurimit të cilat rregullohen me ligjin e Prokurimit Publik i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Në “ Njoftimin për Kontratë ” të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 03.10.2013, tek rubrika “ Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare ” tek pika e Qarkullimit financiar është kërkuar Qarkullim financiar për tri vitet e fundit (2010,2011 dhe 2012) të jetë minimum 6.000.000.00 € dëshmi: nga një apo më shumë banka për qarkullim financiar të licencuara në Kosovë (2010-2012) në rast konzorciumi lideri duhet të ketë jo më pak se 70 % të qarkullimit, pikë e cila bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Tek rubrika “ Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale ” të “ Njoftimit për Kontratë ” pika e) është kërkuar lista e punëve të kryera në lëmin e ndërtimit të lartë minimum 6.000.000.00 € në tri vitet e fundit 2010-2012 dhe se paku dy kontrata të ngjashme (në ndërtim të lartë) të përfunduara në 3 vitet e fundit të jenë në vlerë minimum sa vlera e ofertës, dhe ti bashkëngjiten kopjet e kontratave dhe referencave- asnjë kontratë nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkëngjitur referenca për kryerjen e punëve. Të gjitha kontratat dhe referencat me operator privat llogariten vetëm nëse argumentohet mbyllja e kontratës me transaksione bankare. Lideri duhet të ketë jo më pak se 70 %.

Tek rubrika “ Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale ” pika a të “ Njoftimit për Kontratë ” është kërkuar Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit, që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ekzekutimin e projektit të punëve ose për realizimin e aktiviteteve të ndërtimit me minimum 80 punëtor të deklaruar dhe të vërtetuar nga ATK për tri vitet e fundit duke përfshirë edhe stafin profesional.

Të njëjtat kërkesa të cilat janë kërkuar në “ Njoftimin për Kontratë ” janë përshkruar edhe në “ Dosjen e Tenderit ” të cilën e ka përgatitë A.K.

Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të jetë pjesë e monitorimit për tenderin me titull “ Ndërtimi i Objektit të Shkollës Speciale në Mitrovicë ” me nr. të prokurimit 208 13 067 511. Gjatë monitorimit të këtij aktiviteti të prokurimit është vërejtur se shumica e Operatorëve Ekonomik janë eliminuar si të pa përgjegjshëm për shkak të këtyre kërkesave diskriminuese të formuluar në “ Njoftimin për Kontratë ” dhe “ Dosjen e Tenderit ” që ka përgatitë A.K. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.



Dosjen e tenderit e kanë tërhequr 25 Operator Ekonomik, ndërsa vetëm 9 Operator Ekonomik i kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë tender .

Kriteret e lartë cekura të rubrikës " Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare " dhe " Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale " siç janë përshkruar në " Njoftimin për Kontratë" dhe " Dosjen e Tenderit " janë kritere diskriminuese dhe në këtë mënyrë eliminojnë konkurrencën e lirë dhe favorizojnë Operatorët Ekonomik të caktuar.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale , nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 dhe nenin 25.10 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoriteti Kontraktuese e informon Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

